



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

SHTOJCA 1 e

**Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të
Shqyrtuara në Procese të Tjera**

Publike

Listë e fakteve të propozuara nga Mbrojtja, të shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat ka bërë konstatim gjyqësor Trupi Gjyqësor në pajtim me rregullën 157(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave

Nr.	Fakti i propozuar	Nr. në F01331/A01
735.	Sipas Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ("RSFJ") të 1974-ës, Kosova ishte krahinë autonome brenda Republikës së Serbisë dhe njësi përbërëse e RSFJ-së, dhe kështu ka pasur një shkallë të caktuar vetadministrimi dhe autonomie.	1
736.	Më 28 mars 1989, Kuvendi i Serbisë e ndryshoi Kushtetutën e Serbisë, dhe kështu efektivisht e hoqi statusin autonom të Kosovës.	2
737.	Më 2 korrik 1990, delegatët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës u mbledhën jashtë ndërtesës së Kuvendit dhe deklaruan se heqja e autonomisë së Kosovës ishte e paligjshme dhe se krahina do të mbetej në Federatë vetëm nëse i jepej i njëjti status si republikat e tjera. Kjo deklaratë u shpall e paligjshme nga autoritetet serbe, por ajo provokoi një ndjenjë euforike ndër shqiptarët e Kosovës.	3
738.	Në vitin 1990, Kuvendi i Kosovës dhe qeveria krahinore u suprimuan.	4
739.	Nga marsi 1990, u kufizua arsimimi në gjuhën shqipe, duke qenë se u mbyll një numër gjithnjë e më i madh i shkollave në gjuhën shqipe, dhe iu ndalua hyrja në objektet universitare studentëve dhe profesorëve shqiptarë.	5
740.	Gjatë periudhës 1990 - 1997, hynë në fuqi ligje, politika dhe praktika diskriminuese ndaj shqiptarëve. Shqiptarët e Kosovës u dëbuan nga profesionet, ndërmarrjet e biznesit dhe nga institucionet publike, përfshirë institucionet politike, ekonomike dhe arsimore.	8
741.	Në fillim të viteve 90, u mbyllën gazetat dhe stacionet e radios dhe të televizionit të shqiptarëve të Kosovës, dhe u ndërpreu transmetimet radio-televizive në gjuhën shqipe.	9
742.	Në vitin 1993, shqiptarët e Kosovës që kishin shërbyer në forcën policore në Kosovë, u përpoqën të krijonin një ministri	11

	të mbrojtjes si mënyrë për t'u mbrojtur nga sulmet e mundshme të forcave policore ose ushtarake të Serbisë; sidoqoftë, disa prej individëve të përfshirë u arrestuan menjëherë dhe, nga viti 1995, shumica e anëtarëve të saj ose ishin në burg, ose ishin arratisur jashtë shtetit.	
743.	Më 1 tetor 1997, policia ndërhyri gjatë një tubimi në Prishtinë duke përdorur gaz lotsjellës dhe duke rrahur një numër të madh të studentëve shqiptarë të Kosovës.	12
744.	Autoritetet serbe vazhduan të nxisinin imigrimin ose kthimin në Kosovë të serbëve dhe malazezëve, përfshirë përmes ndihmave për strehim, kurse shqiptarët kosovarë filluan të largoheshin prej krahinës në masë.	13
745.	Nga viti 1998 dhe vazhdimisht gjatë gjithë luftës, një grup drejtuesish politikë, ushtarakë dhe policorë në qeverinë e RSFJ-së dhe atë të Serbisë drejtoi dhe bashkërendoi një fushatë terrori dhe dhune të skajshme në Kosovë, zbatuar nga forcat policore serbe dhe drejtuar kundër popullatës shqiptare të Kosovës.	14
746.	Gjatë fushatës së dhunës kundër popullatës civile të shqiptarëve kosovarë, u kryen vrasje, sulme seksuale, dhe shkatërrim i qëllimshëm i xhamive. Veprimet e qëllimshme të këtyre forcave [serbe] gjatë kësaj fushate shkaktuan largimin nga Kosova të të paktën 700000 shqiptarëve të Kosovës në periudhën e shkurtër prej fundit të marsit deri në fillim të qershorit 1999.	19
747.	Në tetor 1998, në Kosovë ndodheshin rreth 14000 pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë ("MPB"), shifër që arriti në 15779 në prill 1999.	23
748.	Përveç këtyre forcave të rregullta, në Kosovë kishte edhe grupe të ndryshme paraushtarake të kontrolluara nga Serbia dhe që vepronin në bashkërendim me MPB-në serbe.	24
749.	Grupet paraushtarake që vepronin në Kosovë gjatë periudhës 1998-1999 përfshinin Skorpionët, Tigrat e Arkanit, Shqiponjat e Bardha (të njohur edhe si njerëzit e Sheshelit), dhe Merimangat Pauk.	25

750.	Rreth 5 marsit 1998, në rrethinën e Klinës-Llaushës, në jugperëndim të Prekazit, u ndërmor një operacion policor. Raportet treguan se ndërtesat u sulmuan me armë të rënda dhe mortaja. Në operacion morën pjesë forcat serbe të MPB-së dhe forca të lidhura me njësitë e posaçme serbe të pajisura me autobllinda dhe automjete të tjera të rënda.	38
751.	Më 28 shkurt dhe 1 mars 1998, forcat policore serbe sulmuan fshatrat Qirez dhe Likoshan, 2km prej njëri-tjetrit, në zonën e Drenicës. Gjatë sulmit u përdorën helikopterë, autobllinda ushtarake, mortaja dhe mitralozë. Në të dy rastet, forcat policore të posaçme serbe sulmuan pa paralajmërim dhe qëlluan pa dallim mbi civilë. Më 5 mars 1998 apo rreth kësaj date, forcat serbe të sigurisë sulmuan shtëpinë e udhëheqësit të UÇK-së, Adem Jashari, në Prekazin e Poshtëm, një fshat jo larg Likoshanit dhe Qirezit, gjithashtu në zonën e Drenicës. Luftimet, në të cilat u përdorën autobllinda, zgjatën rreth 36 orë. Dëshmitë tregojnë se gjatë sulmeve të shkurtit dhe të marsit 1998 u vranë 83 shqiptarë të Kosovës në zonën e Drenicës. Ndër viktimat e vrara ishin të moshuar dhe të paktën 24 gra dhe fëmijë. Gjatë sulmit në Qirez një grua me barrë u qëllua në fytyrë dhe në Prekazin e Poshtëm u vra një foshnje. [...]. Gjatë sulmit në Prekazin e Poshtëm, u vranë të gjithë pjesëtarët e familjes Jashari, me përjashtim të një vajze 11-vjeçare.	39-40
752.	Rreth 6-8 korrik 1998, forcat serbe sulmuan Loxhën në komunën e Pejës, nga drejtimi i Pejës. Për rimarrjen e fshatit nën kontroll, morën pjesë edhe forcat e FARK-ut.	42
753.	Më 25 dhe 26 korrik 1998, UÇK-ja humbi kontrollin e Llapushnikut në një betejë me forcat serbe, të cilat përbëheshin nga njësi të posaçme të MPB-së, dy reparte me nga 200 ushtarë dhe një njësi antiterroriste.	45
754.	Dikur midis 8 dhe 13 gushtit 1998, forcat serbe kryen operacione midis të tjerash në fshatrat Prilep, Isniq, Baballoq, Rastavicë, Carrabreg, Kodrali, Dubravë, Irzniq, Shaptej, Gramaqel dhe Gllogjan të komunës së Deçanit.	50
755.	Dikur midis 10 dhe 12 gushtit 1998, forcat serbe sulmuan shtabin e UÇK-së në Gllogjan të komunës së Deçanit.	51

756.	Nga 10-15 shtator 1998, forcat e MPB-së kryen një operacion në zonën e Bajgorës dhe Stantergut, komuna e Mitrovicës.	52
757.	Nga fundi i shtatorit 1998, forcat serbe të sigurisë rrethuan disa fshatra në komunën e Vushtrisë, përfshirë Kollën, Dubocin, Galicën, Beçiqin, Oshlanin dhe Zhilivodën dhe, në komunën e Skënderajt, fshatrat Lubavec dhe Mikushnicë.	55
758.	Nga fundi i shkurtit deri në mes të marsit 1999, u kryen operacione të mëdha në komunat e Kaçanikut dhe të Vushtrisë. UJ dhe MPB ndërmorën një ofensivë dhe bllokuan zonat ku po zhvillonin operacionet, duke ndaluar hyrjen e MVK-së.	62
759.	Në mars dhe prill 1999, forcat e UJ-së dhe MPB-së në Turiqec, Tushile dhe Klinë morën pjesë në operacione të përbashkëta gjatë të cilëve shqiptarët kosovarë u dëbuan nga Kosova.	74
760.	Në fillim të prillit 1999, forcat e MPB-së dhe UJ-së dëbuan nga Kosova shqiptarët kosovarë të fshatit Klladërnice.	75
761.	Nga 1 prilli 1999, të paktën 30000 persona të shpërngulur gjendeshin në fshatin Bellanicë, popullsia e të cilit në kohë paqeje ishte 3500.	78
762.	Më 1-2 prill 1999, forcat policore serbe, përfshirë policët vendorë dhe rezervistë, ndërmorën një operacion sulmues të planifikuar dhe të qëllimshëm në lagjen Qerimi të Gjakovës.	81
763.	Më 26 mars 1999, forcat policore dhe paraushtarake serbe arritën në Drenoc në komunën e Deçanit. Më 26 dhe 27 mars 1999 disa prej banorëve ikën në Beleg. Personat e shpërngulur nga Carrabegu, Sllupi dhe fshatra të tjera fqinje u grumbulluan në Beleg.	86
764.	Pasditen dhe në mbrëmjen e 9 majit 1998, ushtarët e UÇK-së filluan të hapnin llogore dhe të ndërtonin fortifikime të tjera në fshatin Llapushnik. Llogoret u hapën natën me ndihmën e disa të rinjve nga fshati.	106
765.	Në zonën e Dukagjinit në vitin 1998, forcat serbe kontrollonin rrugët kryesore, kurse UÇK-ja pak a shumë fshatrat dhe rrugët dytësore në brendësi të zonës.	107

766.	Përveç disa qindra deri në mijëra ushtarësh të rregullt të UÇK-së në fillim të 1998-ës, në mars dhe prill [1998] pati një shtim të madh vullnetarësh në UÇK, duke qenë se fitoi mbështetjen e komuniteteve të shqiptarëve të Kosovës jashtë vendit. Një gjë e tillë kontribuoi për krijimin e një organizate ushtarake kryesisht spontane dhe elementare në nivelin e fshatrave.	108
767.	Njerëzit filluan vetorganizimin në grupe të vogla në fshatrat e tyre pasi zona e Dukagjinit filloi të granatohej, pas sulmit kundër vendbanimit të familjes Haradinaj më 24 mars 1998. Këto grupe njerëzish nëpër fshatra, organizatat e mbrojtjes së fshatrave ose rojet në fshatra nuk u organizuan në mënyrë të centralizuar, por me nismën e fshatarëve. Ato njiheshin si organizata për mbrojtjen e fshatit ose organizata për rojën e fshatit.	110
768.	[Në gjysmën e parë të 1998-ës] ishin organizuar në mënyrë të pavarur afërsisht 17 fshatra të Luginës së Baranit në komunën e Pejës; më shumë se gjysma e fshatrave nuk kishin armë.	111
769.	Nga fundi i prillit/fillimi i majit 1998, shumica e fshatrave të Zonës së Dukagjinit ishin të rrethuara nga forcat e armatosura serbe.	112
770.	Nga marsi deri në shtator të vitit 1998, Zona Operative e Dukagjinit ishte në organizim e sipër.	113
771.	Forcat e FARK-ut u dislokuan në Kosovë dikur para 25 qershorit 1998.	126
772.	Më 20 korrik 1998, në Baran u mbajt një ceremoni betimi për ushtarët e rinj të UÇK-së, në të cilën morën pjesë edhe komandantë të UÇK-së edhe të FARK-ut, përfshirë Tahir Zemajn dhe Ramush Haradinajn.	128